



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 46, datë 30.06.2015

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN NR. 77, DATË 29.06.2011
“MBI PËRCAKTIMIN E VLERËS SË ASETEVE TË SIPËRMARRJEVE TË
INVESTIMIT KOLEKTIV DHE LLOGARITJEN E VLERËS NETO TË ASETEVE TË
TYRE PËR KUOTË OSE PËR AKSION”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, dhe të nenit 112, pika 3, të Ligjit nr. 10 198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 77, datë 29.06.2011 “Mbi përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimit kolektiv dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë ose për aksion”, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohen Departamenti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve për njoftimin, ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Arjan SALATI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI

Ndryshimet në Rregulloren nr. 77, datë 29.06.2011 “Mbi përcaktimin e vlerës së aseteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe llogaritjen e vlerës neto të aseteve të tyre për kuotë ose për aksion

1. Në nenin 3, pika 2, në fund të paragrafit shtohet togfjalëshi si më poshtë:

“... dhe metodologjinë sipas përcaktimit të nenit 4 të kësaj rregulloreje.”

2. Në nenin 4, pika 1, pas togfjalëshit “dispoziat e Ligjit dhe” hiqet fjala:

“parimet e”

3. Në nenin 4, pika 2, riformulohet si më poshtë:

“Asetet dhe detyrimet financiare të një sipërmarrjeje, të cilat tregtohen në një treg aktiv, që në fillim dhe në vijimësi do të vlerësohen dhe mbahen me vlerën e drejtë. Në rastet kur tregu është joaktiv, vlerësimi do të bëhet duke u bazuar në metodologjinë e hartuar nga shoqëria administruese për çdo sipërmarrje që administrojnë, pasi kjo metodologji është konsultuar më parë me depozitarin dhe nuk është refuzuar për zbatim nga ana e Autoritetit brenda 30 ditëve nga dërgimi i saj në Autoritet.”

4. Në nenin 4, pika 3, pas togfjalëshit “do të përdoren normat” hiqet fjala:

“mesatare të”

5. Në nenin 4, pika 3, pas togfjalëshit “kursit të këmbimit të kësaj monedhe në euro” shtohet:

“në fuqi në ditën e transaksionit”

6. Pas nenit 4, shtohet neni 4/1 me titull dhe përmbajtje si më poshtë:

**“Neni 4/1
Tregu aktiv dhe joaktiv**

1. Për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, tregu konsiderohet aktiv nëse:

- a) letrat me vlerë të kapitalit tregtohen aktivisht, për të paktën përgjatë 20 ditëve tregtimi në një periudhë kohe prej tre muajsh;*
- b) letrat me vlerë të borxhit tregtohen aktivisht, për të paktën përgjatë 15 ditëve tregtimi në një periudhë kohe prej tre muajsh.*

2. Shoqëria administruese e sipërmarrjes, në fund të çdo tremujori do të vlerësojë nëse aktiviteti i tregtimit përmbush kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

3. *Shoqëria administruese e sipërmarrjes në politikat e veta kontabël do të përcaktojë kriteret të qarta në bazë të të cilave klasifikohet ai transaksion, çmimi i të cilit nuk përfaqëson vlerën e drejtë, ose transaksionet që nuk përmbushin kriteret sipas paragrafit 1 të këtij neni, duke marrë parasysh faktorë, të tillë si vëllimi i tregtimit, numri i transaksioneve, apo ndryshimi i çmimeve.*
4. *Përveç përcaktimeve në paragrafët 1 dhe 3 të këtij neni, shoqëria administruese do të përcaktojë nëse vepron në treg aktiv apo jo aktiv duke marrë parasysh edhe:*
 - a) *vëllimin e tregtimit të krahasuar me vëllimin mesatar të tregtimit për periudhën tremujore;*
 - b) *diferencën ndërmjet çmimit më të fundit të ofruar për blerje dhe çmimit më të fundit të ofruar për shitje; dhe*
 - c) *vëllimin e tregtimit në raport me kapitalizimin e tregut në periudhë tremujore;*
 - d) *vëllimin e tregtimit të krahasuar me madhësinë e emetimit për letrat me vlerë të borxhit për periudhën tremujore.*
5. *Shoqëria administruese mund të zbatojë dispozitat e këtij neni për një instrument financiar, i cili në momentin e vlerësimit i referohet paragrafit 2 të këtij neni dhe është përfshirë në tregje sipas përcaktimit në paragrafin 1, neni 87 i Ligjit për një periudhë prej më pak se tre muaj, në përpjesëtim me periudhën e listimit të instrumentit financiar.*
6. *Shoqëria administruese do të jetë përgjegjëse për identifikimin, sigurimin dhe ruajtjen e dokumentacionit që vërteton përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në paragrafët 1 deri në 5 të këtij neni.”*
7. **Pas nenit 10, shtohet neni 10/1 me titull dhe përmbajtje si më poshtë:**

“Neni 10/1
Metodologjia e vlerësimit

1. *Shoqëria e administrimit do të hartojë metodologjinë e vlerësimit të aseteve për çdo sipërmarrje që ka nën administrim. Metodologjia do të përmbajë të paktën elementët e mëposhtëm:*
 - a) *burimin kryesor të përdorur për të përcaktuar çmimin e vlerësimit, si dhe tregun kryesor në të cilin tregtohet instrumenti financiar, ku ka investuar ose synon të investojë sipërmarrja e investimit dhe nga i cili burojnë çmimet e kuotuar për qëllime të vlerësimit;*
 - b) *burimin dytësor të çmimit të ofruar, nëse ekziston, dhe kushtet në të cilat do të përdoren çmimet e marra nga burime të tjera, në rastet kur nuk ka çmim sipas kuptimit të nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe shkronjës a të këtij paragrafi;*
 - c) *teknikat e vlerësimit që do të përdoren për përcaktimin e vlerës së letrave me vlerë dhe instrumenteve të tregut të parasë, në rast se tregu është joaktiv;*
 - d) *dokumentacionin që do të shërbejë për të mbështetur përshtatshmërinë e treguesve ose vlerave të përdorura në procesin e vlerësimit.*

2. *Shoqëria e administrimit do të depozitojë në Autoritet metodologjinë e vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve financiare, të hartuara sipas përcaktimeve në paragrafin 1 të këtij neni, në procesin e licencimit për të gjitha llojet e investimeve që fondi synon të kryejë, në rastin e një investimi që do të kryhet për herë të parë në një instrument financiar të caktuar ose klasë instrumenti, ose kur kushtet e tregut e bëjnë të nevojshme kryerjen e ndryshimeve. Kjo metodologji do të depozitohet pasi të jetë konsultuar më parë me depozitarin dhe shoqërinë audituese, dhe së bashku me komentet e tyre, si dhe do të zbatohet me miratimin nga Autoriteti ose brenda 30 ditësh nga depozitimi, nëse gjatë kësaj periudhe Autoriteti nuk ka kërkuar rishikim të saj.*
3. *Autoriteti mund, në çdo kohë, të kërkojë rishqyrtimin tërësor ose pjesor të metodologjisë, nëse gjykon se nga zbatimi i saj nuk krijohen kushte për vlerësimin e drejtë të aseteve dhe të kuotave të fondeve. Metodologjia e rishikuar do të depozitohet në Autoritet brenda 7 ditësh nga paraqitja e kërkesës për rishqyrtim, dhe do të zbatohet brenda 15 ditësh nga depozitimi i saj, nëse gjatë kësaj periudhe Autoriteti nuk është shprehur ndryshe.”*

8. Në nenin 11, titulli ndryshon si më poshtë:

“Trajtimi i aseteve financiare të vlerësuara me kosto të amortizuar”

9. Në nenin 11, pika 1 riformulohet si më poshtë:

“Asetet financiare të klasifikuara si kredi dhe llogari të arkëtueshme do të vlerësohen me koston e amortizuar, duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit. Depozitat, investimet, duke përfshirë edhe letrat me vlerë të borxhit të emetuara nga emetues me seli në Republikën e Shqipërisë, do të vlerësohen pa dallim me vlerën e tregut, sipas përcaktimeve të neneve 7 dhe 10 të kësaj rregulloreje.”

10. Në nenin 11, pika 3 riformulohet si më poshtë:

“Asetet e mbajtura deri në maturim për periudhën në vijim ose në rastin e shitjes së një pjese të tyre, do të rivlerësohen me vlerën e drejtë.”

11. Në nenin 11, pika 5 hiqet.

12. Në nenin 18, pika 3, togfjalëshi “duhet që me kërkesën e Autoritetit” zëvendësohet me:

“janë të detyruar”

13. Në nenin 18, pika 3, në fund të paragrafit shtohet fjalia:

“Këtë ndryshim ka të drejtë ta kërkojë dhe Autoriteti”

14. Pas nenit 18, shtohet neni 18/1 me titull dhe përmbajtje si më poshtë:

***“Neni 18/1
Dispozita kalimtare***

1. *Rivlerësimi tërësor i aseteve sipas përcaktimeve të nenit 11 të kësaj rregulloreje, për fondet që janë në treg përpara datës së hyrjes në fuqi të këtyre amendimeve do të kryhet brenda dy vjetësh nga hyrja në fuqi e këtyre amendimeve.*
2. *Shoqëria administruese e sipërmarrjes do të paraqesë në Autoritet për miratim planin kohor të rivlerësimit tërësor të aseteve sipas paragrafit 1 të këtij neni, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtyre amendimeve. Ky plan do të shoqërohet me analizë të hollësishme të portofolit, dokumentacionin e vlerësimit teknik, si dhe metodologjitë që shpjegojnë mënyrën e vlerësimit.”*